

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE INDUSTRIVE
KREATIVE**

DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS DHE DIZAJNIT

KËRKIMI SHKENCOR NË NIVEL DEPARTAMENTI

2021-2026

Tiranë, 14.05.2026

Përgjegjësi i Departamentit të Arkitekturës dhe Dizajnit

Prof. Asoc. PhD. Ark. Etleva Dobjani

1. Aktiviteti kërkimor i departamentit

Kërkimi shkencor i aplikuar dhe inovacioni përbëjnë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit akademik dhe profesional në fushën e arkitekturës, dizajnit, urbanistikës, inxhinierisë dhe trashëgimisë kulturore. Përmes angazhimit në projekte kërkimore, publikime shkencore, konferenca ndërkombëtare dhe bashkëpunime akademike, synohet promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm, inovacionit dhe integritit të praktikave bashkëkohore në arkitekturë dhe planifikim urban. Aktiviteti kërkimor fokusohet në adresimin e sfidave aktuale që lidhen me transformimin urban, ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore, eficiencën energjetike, arkitekturën e qëndrueshme, si dhe aplikimin e teknologjive inovative në projektim dhe ndërtim.

Në këtë kuadër, kërkimi shkencor dhe inovacioni mbështeten në:

- Projekte kërkimore-shkencore në fushën e arkitekturës, dizajnit urban, trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Publikime shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti;
- Pjesëmarrje në konferenca, seminare dhe aktivitete shkencore ndërkombëtare;
- Hartimin e monografive, kapitujve të librave dhe botimeve akademike në bashkëpunim me institucione ndërkombëtare;
- Bashkëpunime ndërdisiplinore në kuadër të projekteve mbi rigjenerimin urban, eficiencën energjetike dhe ruajtjen e identitetit arkitekturor;
- Aktivitet editorial dhe angazhim në komitete shkencore të botimeve ndërkombëtare.

Aktualisht, puna kërkimore është e fokusuar në tematika që lidhen me trashëgiminë arkitekturore dhe kulturore, qytetet nëntokësore dhe arkitekturën ushtarake, transformimin urban dhe identitetin e qyteteve, arkitekturën e qëndrueshme dhe materialet tradicionale të ndërtimit, rigjenerimin urban, eficiencën energjetike në ndërtesa, si dhe përdorimin e teknologjive inovative për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit të ndërtuar. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë i kushtohet kërkimeve mbi urbanizmin e gjelbër, zhvillimin e zonave bregdetare, adaptimin e ndërtesave ekzistuese dhe integrimin e inteligjencës së avancuar në arkitekturë dhe dizajn.

Përmes publikimeve shkencore, pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve me universitete e institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, synohet forcimi i dimensionit ndërkombëtar të kërkimit shkencor dhe kontributi në zhvillimin e praktikave inovative në arkitekturë, dizajn, trashëgimi kulturore dhe zhvillim të qëndrueshëm.